

1. Xhoni e ka ndarë shumësin e shkollës në dy pjesë të cilat i ka shenjëzuar si Mostra A dhe Mostra B. Mostra A është dyfish më e madhe nga Mostra B. Cili prej pohimeve të mëposhtme është i saktë?

- A. Mostra A ka dendësi më të madhe nga mostra B.
B. Mostra B ka dendësi më të madhe nga mostra A.

C. Mostra A dhe mostra B kanë dendësi të njëjtë.


D. Mostra A dhe mostra B kanë dendësi më të vogël nga shumësi origjinal i shkollës.

2. Një cilindër gazi i vogël i mbushur me helium mund të shërbejë për mbushje të shumë tullumbaceve. Cila është arsyeja për këtë?

- A. Heliumi është lëng.
B. Tullumbacet janë të ngurta.
C. Grimcat e heliumit gjenden në largësi më të madhe në cilindrin e gaztë sesa në tullumbace.

D. Largësia në mes grimcave ndryshon.

3. Çka është përshkruan me **D** në grafikun vijues, i cili i përket ujit në temperatura të ndryshme (të paraqitura në °C)?



- A. Sublimimi.
B. Vlimi.
C. Ngrirja.
D. Shkrirja.

4. Në cilat prej formulave vijuese që të dy elementet kanë valencë të njëjtë?

- A. NH_3 B. CaO
C. CaH_2 D. N_2O

5. Çka nga e përmendura për grafitin NUK ËSHTË e saktë:

- A. Paraqet modifikim(formë) alotropik të karbonit.
B. Ai është jometal dhe përcues i mirë i elektricitetit.

C. Ai është jometal dhe izolues i mirë i elektricitetit.

D. Ai është jometal dhe përcues i mirë i nxehtësisë.

6. Çka nga e përmendura është substancë e thjeshtë?

- A. Diamanti.
B. Qelqi.
C. Çeliku.
D. Kripa e kuzhinës.

7. Cili prej pohimeve të përmendura përshkruan reaksion kimik?

A. Kur në gotë me ujë të nxehtë vendoset qese e çait, ngjyra e tretësirës ndryshon.

B. Çatia e bakrit me kalimin e viteve e ka ndryshuar ngjyrën e vet në të gjelbër.

C. Bluza e bardhë ka fituar ngjyrë të kuqe nga lëngu i derdhur nga boronica.

D. Drithi në figurë është i pikturuar me shkathësi me anë të përzierjes së ngjyrës së verdhë dhe të kaftë.

8. Me ndihmë të metodave kimike Majlinda e ka zbërthyer një substancë me ngjyrë të gjelbër. Nga kjo ka fituar gaz të verdhë në të gjelbër dhe substancë të ngurtë me ngjyrë të kuqe në të kaftë. Nga substancat e fituara me zbatim të metodave fizike dhe kimike nuk ka fituar substanca të reja. Çka paraqet substanca e verdhë në të gjelbër?

- A. Metal.
B. Indikator.
C. Substancë elementare.
D. Përzierje prej gazrave.

9. Në cilët prej radhët e përmendura zvogëlohet karakteri acidik i acideve?

- A. $\text{pH} = 3$, $\text{pH} = 6$, $\text{pH} = 9$
B. $\text{pH} = 7$, $\text{pH} = 8$, $\text{pH} = 9$
C. $\text{pH} = 1$, $\text{pH} = 3$, $\text{pH} = 6$
D. $\text{pH} = 6$, $\text{pH} = 3$, $\text{pH} = 1$

10. Një përzierje përbëhet nga kloruri i natriumit, shkumësit dhe hekurit. Vetëm kloruri i natriumit tretet në ujë. Për ndarjen e tyre përdoren: destilimi, përdorimi i magnetit, shtimi i ujit dhe filtrimi. Cila është renditja e mundshme e udhëzimeve për ndarje të klorurit të natriumit, shkumësit dhe hekurit nga përzierja?

- A. Shtimi i ujit, filtrimi, zbatimi i magnetit dhe destilimi.
- B. Shtimi i ujit, zbatimi i magnetit, destilimi dhe filtrimi.
- C. Zbatimi i magnetit, shtimi i ujit, destilimi dhe filtrimi.
- D. Shtimi i ujit, zbatimi i magnetit, filtrimi dhe destilimi.

11. Cila është formula e nitratit të bakrit(II)?

- A. Cu_2NO_2
- B. Cu_2NO_3
- C. $\text{Cu}(\text{NO}_3)_2$
- D. CuNO_2

12. Çka mungon në barazimin tekstual:
karbonati i kalciumit + acidi acetik \rightarrow
 \rightarrow acetati i kalciumit + _____ + _____

- A. hidrogjen dhe dioksid karbon.
- B. hidrogjen dhe monoksid karbon.
- C. ujë dhe monoksid karbon.
- D. ujë dhe dioksid karbon.


13. Çka fitohet gjatë reaksionit të acidit sulfurik dhe natriumit?

- A. Sulfit natriumi dhe ujë.
- B. Sulfat natriumi dhe ujë.
- C. Sulfat natriumi dhe hidrogjen.
- D. Hidroksidi i natriumit dhe dioksidi i sulfurit.

14. Reaktantët në reaksionin e neutralizimit janë:

- A. kripë dhe ujë.
- B. acid dhe bazë.
- C. metal dhe oksigjen.
- D. metal dhe acid.

15. Në cilët prej rasteve të mëposhtme fitohet kripë?



- A. Tek të gjitha.
- B. I dhe V.
- C. IV dhe V.
- D. I, III dhe V.

II DETYRA

Shkruaje përgjigjen në vendin e paraparë

1. Në fotografi janë të paraqitur cilindra të shkallëzuar (menzura) me vëllim të njejtë të tretësirës. Vëllimi më i madh i cili mund të matet me menzurën e vogël është 50 mL.


Sa vëllim të tretësirës gjendet në çdonjërin nga menzurat? 40 mL

Sa është vëllimi maksimal i cili mund të matet me menzurën më të madhe? 100 mL

Rretho shkronjën para përgjigjes së saktë.

Tretësira me vëllim 22 mL mund që saktë të matet:

- A. me menzurën e vogël
- B. me menzurën e madhe
- C. me asnjërën nga menzurat
- D. me që të dy menzurat



3 pikë (1+1+1)

2. Jeta ka kryer eksperimente në orë të kimisë.

I. Për çdonjërin pohim rretho PO nëse është i saktë ose JO nëse është i pasaktë.

Reaksioni kimik ka ndodhur atëher kur shiritin e magnezit:

e vendosim në epruvetë, e lyejmë me acid klorhidrik dhe vërejmë fluska PO JO

e prejmë në copa më të vogla. PO JO

e vendosim në zjarr nga çka vërejmë pluhur të bardhë. PO JO

3 pikë (3 × 1)

II. Shkruaj barazimet të përbëra me fjalë të cilat i përshkruajnë reaksionet kimike:

Magnez + acid klorhidrik → klorur magnezi + hidrogjen

Magnez + oksigjen → oksid magnezi

2 pikë (2 × 1)

III. Shkruaj barazimet me ndihmë të simboleve dhe formulave!

$Mg + 2HCl \rightarrow MgCl_2 + H_2$

$2Mg + O_2 \rightarrow 2MgO$

3 pikë (2 × 1,5)

3. Shkruaj formulat ose emrat e komponimeve vijuese.

oksid i hekurit(III) Fe₂O₃

sulfit natriumi Na₂SO₃

ZnO oksid zinkut

NH₄Cl klorur amoni

4 pikë